



REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E LIPJAN  
KOMUNIKACIONE  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E LIPJAN

Pranuar më Primljeno:	25.01 2021		
Njësia Jedritë:		Shtojca Dodatak:	
1-312-5242			

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

### NDËRMJET

**AGJENCISË SË KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

**DHE**

**KOMUNËS SË LIPJANIT**

**Për zbatimin e Pilot Projektit**

**“Promovimi i Eficiencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë”**

**PRISHTINË, 2021**

## **NENI 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të sigurohet bashkëpunimi i dakorduar dhe i ngushtë midis palëve nënshkruese në implementimin e pilot projektit “Promovimi i Efiçencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të Efiçencës së Energjisë”, duke përdorë sistemin efiçient të ndriçimit.

## **NENI 2**

### **Baza ligjore**

Ky projekt është në pajtim të plotë me zbatimin e Planit Nacional për Efiçencë të Energjisë, dhe është vazhdim i bashkëpunimit në fushën e promovimit të efiçencës në mes të Ministrisë dhe Komunave të Kosovës e që kontribuon në përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE).

## **NENI 3**

### **Përgjegjësitë e Palëve**

1. Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë do të kontribuoj si në vijim:

- 1.1 Menaxhimi dhe koordinimi i përgjithshëm i projektit, duke përfshi organizimin e takimeve për progresin e projektit dhe konsultimet e nevojshme.
- 1.2 Ofrimi i përkrahjes financiare në vlerë prej € 105,600.00 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind Euro) ndaj Komunës së Lipjanit nga këto dy kode 15372 Programi i zbatimit të masave të EE dhe 18364 Zbatimi i masave të EE dhe BRE në Qendren për Ekselenc Digjitale në ITP – Prizren, pagesë e cila do të përmbillet brenda tri viteve ndaj Komunës.
- 1.3 Prezantimi i rezultateve tek njësia kërkuese dhe agjencitë tjera qeveritare, si dhe tek akterët tjerë.
- 1.4 Mbikëqyrja e progresit të projektit

2. Komuna e Lipjanit do të kontribuoj si në vijim:

- 2.1 Menaxhimi dhe koordinimi i projektit,
- 2.2. Bashkë-financimi i projektit në shumën prej € 26,400.00 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind Euro) në periudhë tre vjeçar

3. Prezantimi i rezultateve të projektit në Kolegjiunin e Drejtorëve të Shërbimeve Publike, Asociacionin e Komunave të Kosovës si dhe ministritë përkatëse e akterët tjerë,

4. Përpilimin i raportit përfundimtar brenda dy javëve pas përfundimit të projektit

#### **NENI 4**

#### **Menaxhimi dhe Mbikqyrja e Projektit**

1. Palët nënshkruese pajtohen që të emërojnë një Menaxher të kontratës për mbikëqyrjen e implementimit të projektit, sa i përket transparencës dhe kualitetit të punimeve, në përputhje me dokumentacionin dhe brenda kornizës buxhetore.
2. AKEE do të jetë përgjegjës për procedurat e prokurimit, menaxhimin e tenderit dhe kontratës sipas Ligjit të Prokurimit Publik të aplikueshëm, përfshirë nënshkrimin e kontratës me ofertuesin e suksesshëm.
3. AKEE dhe Komuna e Lipjanit do të pajtohen për procedurat e pagesave për palën e kontraktuar për kryerjen e punimeve si dhe atë të mbikëqyrjes bazuar në kushtet e kontratës.
4. AKEE dhe Komuna e Lipjanit pajtohen të zhvillojnë një plan zbatues Brenda një jave pas nënshkrimit të MeM.
5. AKEE dhe Komuna e Lipjanit do të komunikojnë rregullisht me njëra tjetrën për të koordinuar aktivitetet që lidhen me këtë marrëveshje.
6. Palët e nënshkruara sigurojnë që personat të cilët janë të angazhuar në përgatitjen dhe implementimin e masave të specifikuar në Marrëveshjen e Mirkuptimit dhe nënshkrimin e kontratës për furnizim dhe shërbime të cilat do të financohen, nuk do të kërkojnë, pranojnë, apo të marrin premtim për pagesë të ndonjë shume ilegale apo ndonjë përfitim të llojit tjetër në lidhje me këto detyra.

#### **NENI 5**

#### **Ndryshimi i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e nënshkruesve të Marrëveshjes.

#### **NENI 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Z. Arsim Kalliqi

  
Kryeshër Ekzekutiv



Prishtinë, më 22/09/2021

Komuna e Lipjanit

Z. Imri Ahmeti

  
Kryetar i Komunës



Prishtinë, më 20/09/2021